

Monitorimi i Reformës në Administratën Publike (RAP) për Shqipërinë

STRATEGJIA E RAP

2024/2025



Institute
for Democracy
and Mediation



PUBLIKIMI:

Monitorimi i Reformës
në Administratën Publike (RAP) për Shqipërinë 2024/2025

PUBLIKUAR NGA:

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

AUTORËT:

Naim Çabej – Hulumtues, Instituti për
Demokraci dhe Ndërmjetësim
Iliada Korçari – Hulumtues, Instituti
për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Përkthyer nga: Gaspër Gjeluçi

PËRMBAJTJA

FALENDERIME	4
RRETH WEBER 3.0	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
SHKURTIME DHE AKRONIME	8
I. MONITORIMI WEBER I RAP: ÇFARË MONITOROJMË DHE SI?	9
I.1 QASJA E WEBER NË MONITORIMIN E RAP	9
I.2 PSE DHE SI E MONITORON WEBER FUSHËN E STRATEGJISË SË RAP	10
II. TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA NË ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E AGJENDËS SË RAP	15
II.1 TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA NË ZHVILLIMIN E DOKUMENTAVE PLANIFIKUES TË RAP	15
SI PARAQITET SHQIPËRIA NË ASPEKTIN RAJONAL?	21
II.2 TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA E STRUKTURAVE TË MONITORIMIN DHE KOORDINIMIT TË RAP	21
SI PARAQITET SHQIPËRIA NË ASPEKTIN RAJONAL?	24
KRAHASIMI I PIKËVE TOTALE NË STRATEGJINË PËR RAP	26
II.3 REKOMANDIME PËR STRATEGJINË E RAP	27
II.3.1 NDJEKJA E REKOMANDIMEVE NGA MONITORIMI I RAP NË VITIN 2021/2022	27
II.3.2 REKOMANDIMET NGA RAPORTI I MONITORIMIT 2024/2025	29
METOLOGJIA	30
LISTA E BURIMEVE TË REFERUARA NË KËTË RAPORT	34

FALENDERIME

Strategjia për RAP në Shqipëri për vitin 2024/2025 është një produkt që del nga një proces monitorimi që ka zgjatur një muaj e gjysëm, dhe është bazuar në teknika të ndryshme të mbledhjes së të dhënave të cilat kanë rezultuar në një mori gjetjesh.

Ashtu si edhe në rastet e raporteve të mëparshme të monitorimit në nivel kombëtar të RAP, të botuara në vitet 2017/2018, 2019/2020 dhe 2021/2022, falenderime të veçanta i shkojnë anëtarëve të platformës WeBER dhe Grupit Kombëtar të Punës në Shqipëri, gjithashtu dhe aktorëve të tjerë që ndanë me ne përvojat e tyre përmes intervistave, ku kontribuan jashtëmase në përmbajtjen e këtij raporti dhe në cilësinë e tij, por të cilët nuk do të identifikohen në respekt të parimit të anonimitetit.

Së fundi, ekipi i WeBER 3.0 dëshiron të falënderojë edhe partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë, të cilët kanë mbështetur projektin në kërkimin shkencor dhe veprimtari të tjera. Këtu përfshihen Sigma (Mbështetja për Përmirësimin në Qeverisje dhe Menaxhim)¹, ReSPA (Shkolla Rajonale e Administratës Publike), Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit dhe Ministria për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në Shqipëri, si bashkëpunëtore e projektit.

¹ Një iniciativë e përbashkët mes Bashkimit Europian dhe OECD-së.

RRETH WEBER 3.0

Duke u bazuar në rezultatet e dy projekteve të mëparshme WeBER (2015 – 2018) dhe WeBER 2.0 (2019 – 2023), projekti **Nxjtja e Reformimit të Administratave Publike të Ballkanit Perëndimor Weber 3.0**, është projekti i tretë radhazi i financuar nga BE-ja si iniciativa më e madhe e shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e reformës në administratën publike (RAP) në Ballkanin Perëndimor. Periudha e zbatimit është nga shkurti 2023 deri në korrik 2026. Të udhëhequra nga parimet e SIGMA/OECD, dy fazat e para të kësaj nisme hodhën themelet e qëllimit të WeBER 3.0 **për të fuqizuar më tej organizatat e shoqërisë civile (OSHC), në mënyrë që ato të kontribuojnë në institucione publike më transparente, të hapura, të përgjegjshme, të përqendruara te qytetari dhe, rrjedhimisht, më në përputhje me standardet e BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor.**

WeBER 3.0 vazhdon të promovojë rolin kryesor që luajnë OSHC në RAP, ndërkohë që avokon gjithashtu për një angazhim më të gjerë të qytetarëve në këtë proces dhe për masa reformuese gjithëpërfshirëse, të cilat janë të përshtatura sipas nevojave të përdoruesve dhe që sjellin përmirësime të prekshme.

Duke i bazuar veprimet në të dhëna dhe analiza monitorimi të sakta, WeBER 3.0 fuqizon shoqërinë civile që të ndikojë në mënyrë më efikase në hartimin dhe zbatimin e RAP. Për të nxitur një politikëbërje bashkëpunuese dhe për të kapërcyer hendekun midis aspiratave dhe zgjidhjeve të zbatueshme, projekti ka si qëllim të lehtësojë një dialog politik të qëndrueshëm midis qeverive dhe OSHC-ve përmes Platformës WeBER dhe Grupeve Kombëtare të Punës për RAP-in. Së fundi, përmes granteve të vogla për OSHC-të vendore, WeBER 3.0 forcon angazhimin për RAP-in në nivel vendor, duke forcuar pjesëmarrjen e qytetarëve – përfituesit fundorë të punës së institucioneve publike.

Produktet e WeBER 3.0 dhe informacionet e mëtejshme rreth tyre janë të disponueshme në faqen zyrtare të projektit: www.par-monitor.org.

WeBER 3.0 zbatohet nga Rrjeti “Think for Europe” (TEN), i përbërë nga gjashtë institute kërkimore të orientuara drejt politikave të BE-së në Ballkanin Perëndimor:



Në bashkëpunim me Qendrën për Kërkime në Administratën Publike (KDZ) në Vjenë, WeBER 3.0, ka siguruar mbështetje në ekspertizë të nivelit të BE-së, veçanërisht në zhvillimin e metodologjisë të përqendruar te qytetari në zgjidhjen e problematikave të RAP në nivel lokal.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vlerësimi i transparencës dhe përfshirjes së agjendës së RAP në këtë raport fokusohet në dy çështje kryesore – 1) zhvillimin e dokumenteve planifikues të RAP me pjesëmarrjen e aktorëve jo-shtetëror, dhe 2) përfshirjen e shoqërisë civile në mekanizmat koordinues dhe monitorues qeveritar të RAP. Për të parën, vlerësimi vë në pah kërkesat bazë rregullatore për zhvillimin e konsultimeve, duke vijuar me vlerësimin e praktikës së përfshirjes së aktorëve të jashtëm dhe publikut në fazat e ndryshme të zhvillimit të politikave për një kampion të katër dokumenteve planifikues të RAP të miratuara që në raportin e monitorimit të RAP 2021/2022. Për çështjen e dytë, ky raport shqyrton shkallën dhe mënyrat e përfshirjes së OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë në koordinimin dhe monitorimin e RAP-it, si në nivel politik ashtu edhe në nivel administrativ, duke theksuar sa e institucionalizuar dhe sa domethënëse është në praktikë kjo përfshirje. Gjetjet e këtij raporti pasqyrojnë periudhën pas publikimit të Monitorimit të RAP-it 2021/2022, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2022 deri në fund të vitit 2024.²

Në fushën e dokumenteve planifikuese, kuadri ligjor i Shqipërisë, i mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjin nr. 146/2014, ofron një bazë të qëndrueshme për pjesëmarrjen e publikut dhe aktorëve jo-shtetërorë, duke garantuar që palët e interesuara të informohen, të mund të paraqesin komente dhe që këto komente të merren në konsideratë. Megjithatë, në praktikë, proceset e konsultimit mbeten të paqëndrueshme për dokumentet që përbëjnë kuadrin strategjik të RAP-it, si: Udhërrëfyesi për RAP 2023–2030, Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030 dhe Plani i Veprimit 2023–2026, Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 dhe Plani i Veprimit 2023–2025, si dhe Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026”, e cila pasqyron afatet e përditësuar dhe prioritetet e reformës. Konsultimet e hershme me OSHC-të dhe aktorët e tjerë jo shtetëror zakonisht zhvillohen në kohë dhe përfshijnë disa aktorë, megjithatë pjesëmarrja kryhet përmes ftesave, duke kufizuar kështu transparencën. Gjithashtu, shpërndarja e materialeve dhe mekanizmave të marrjes së përshtypjeve ndryshon ndjeshëm nga një dokument në tjetrin.

Në mënyrë të ngjashme, edhe në fushën e monitorimit dhe koordinimit të RAP-it, kuadri përkatës, i cili funksionon në kuadër të Grupeve të Menaxhimit të Integritetit të Politikave dhe rregullohet nga urdhra zyrtarë të Kryeministrit që përditësohen shpesh, parashikon pjesëmarrjen e shoqërisë civile vetëm si anëtare e ftuar dhe jo si pjesë të përhershme.

² Për vitin 2022, përfshihen vetëm zhvillimet që nuk janë pasqyruar nga PAR Monitor 2021/2022.

Si pasojë, përfshirja e OSHC-ve është e rastësishme (ad hoc), ndërsa mbledhjet zhvillohen në mënyrë jo të rregullt, me dokumentim të pamjaftueshëm (p.sh., mungesë të procesverbaleve dhe raportim online jo të përditësuar). Intervistat me ekspertë jo-shtetërorë, të cilët kanë marrë pjesë në konsultimet për dokumente të ndryshme strategjike të RAP-it, gjithashtu i ngrejnë këto problematika. Ata vërejnë se, ndonëse është bërë një përparim i moderuar në integrimin e OSHC-ve, kontributet e tyre nuk kanë ndikuar ndjeshëm në finalizimin e strategjive, ndërsa vazhdojnë problemet sistemike, si vonesat në shpërndarjen e informacionit dhe koordinimi jo i duhur.

Në përgjithësi, Shqipëria e plotëson bazën ligjore për procese transparente dhe përfshirëse por kërkon përmirësime të qenësishme në mënyrë që proceset e planifikimit, konsultimit dhe të monitorimit për dokumente kryesore të administratës publike të jenë të zhvilluara përmes një procesi transparent të qëndrueshëm dhe me pjesëmarrje domethënëse. Rekomandohet që institucionet përgjegjëse të rrisin transparencën për procesin e konsultimit duke miratuar procedurat për thirrje të hapura për përfshirjen e OSHC-ve në fazat e para të konsultimit dhe ndarjen në kohë të materialeve përgatitëse.

Gjithashtu, janë të nevojshme përmirësime në mekanizmat e marrjes së përshtypjeve, siç është publikimi në kohë dhe në detaje i rezultateve të konsultimit. Gjithashtu këshillohet që strukturat e monitorimit dhe të koordinimit të sqarojnë mënyrën e punës së tyre, të rrisin shpeshtësinë e takimeve, të sigurojnë pjesëmarrjen e vazhdueshme të OSHC-ve përmes thirrjeve të hapura dhe jo veç përmes ftesave të rastit, dhe të përditësojnë informacionin në kohë reale përmes platformave si Sistemi i Planit të Integruar.

SHKURTIME DHE AKRONIME

BE	Bashkimi European
DAP	Departamenti i Administratës Publike
GMIP	Grup për Menaxhimin e Integritetit të Politikave
GP	Grupet e Punës
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IDRA	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik Strategic Planning Committee
MFP	Mirëadministrimi i Financave Publike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
RAP	Reforma në Administratën Publike
RESPA	Shkolla Rajonale e Administratës Publike
RVN	Raporti i Vlerësimit të Ndikimit (të Legjislacionit)
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SIGMA	Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Miradministrimit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
WeBER	Projekti për Mundësimin e Monitorimit të Reformës në Administratën Publike nga Shoqëria Civile në Vendet e Ballkanit Perëndimor

I. MONITORIMI I RAP WEBER: ÇFARË MONITOROJMË DHE SI?

I.1 Qasja e WeBER në monitorimin e RAP

Metodologjia e Monitorimit të Reformës së Administratës Publike (RAP) u zhvillua në vitet 2015–2016, si pjesë e projektit të parë “Projekti i Ballkanit Perëndimor për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Monitorimin e Reformës së Administratës Publike” (WeBER). Që në fillim, WeBER ka ndërmarrë një qasje të bazuar në të dhëna si përpjekje për të shtuar rëndësinë, pjesëmarrjen dhe kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor, për të avokuar dhe ndikuar në hartimin dhe zbatimin e RAP. Zhvillimi i metodologjisë për monitorimin e RAP është një nga rezultatet kryesore të projektit, e cila ka si qëllim të lehtësojë punën e shoqërisë civile në monitorimin e RAP bazuar në të dhëna dhe analizë.

Në linjë me fokusin e WeBER mbi procesin e integritetit të rajonit në BE, kur SIGMA rishikoi në 2023 *Parimet e Administratës Publike*³, WeBER gjithashtu rishikoi metodologjinë e monitorimit të RAP në 2024. Kjo është bërë me qëllim që rekomandimet e WeBER-it të mbeten të përqendruara te reformat në përputhje me standardet e BE-së, duke udhëhequr kështu qeveritë e rajonit drejt një anëtarësimi të suksesshëm në BE në të ardhmen. Ndryshimet kryesore në metodologjinë e rishikuar të monitorimit të RAP janë të rënditura më poshtë.⁴

Tabela 1: Ndryshimet kryesore në metodologjinë e monitorimit

Stuktura

- Përdorimi i një treguesi të vetëm për secilën fushë të RAP, i ndarë në nëntregues, të cilët ndahen më tej në disa elementë (kriteret specifike të vlerësuar)
- Përdorimi i disa elementeve të treguesve, që do të thotë që secili element ka një fokus të veçantë në një nga aspektet e reformës:
 1. Strategjia dhe Politika
 2. Legjislacioni
 3. Struktura Institucionale
 4. Praktika në zbatim, dhe
 5. Rezultatet dhe impakti
- Përdorimi i një shkalle prej 100 pikësh, e cila mundëson një vlerësim më të detajuar të progresit në secilën prej fushave të RAP.

³ E disponueshme në: <https://www.sigmaweb.org/publications/principlesofpublicadministration.htm>.

⁴ Për informacion të detajuar mbi qëllimin dhe procesin e rishikimit të metodologjisë shikoni: <https://www.par-monitor.org/par-monitor-methodology/>.

Burimet e të dhënave

- Intervistat me “informatorë kyç”, pra aktorë jo-shtetërorë të angazhuar dhe të njohur me proceset. Këto intervista shërbejnë si burim të dhënash për elementët “Rezultate dhe impakti”, në vend të anketës së mëparshme me organizatat e shoqërisë civile.
- Përdorimi i anketave të perceptimit të opinionit publik si burim të dhënash për “rezultatin dhe impaktin”, dhe zgjerimi i fushëveprimit për të plotësuar vlerësimin në pesë fusha të RAP, me përjashtim të “strategjisë së RAP”
- Heqja e anketimit të nëpunësve civil si burim i të dhënave për shkak të problematikave të përsëritura në sigurimin e një shkalle të përshtatshme të përgjigjeve në të gjithë administratat e rajonit.

Raportimi i monitorimit të RAP

- Gjashtë raporte kombëtare monitorimi të RAP, një për fushë të RAP (36 në total për të gjithë monitorimin e RAP), për të mundësuar publikimin në kohë dhe për të avokuar mbi rezultatet e monitorimit në vend të publikimit të rezultateve të 18 muajve kërkime në fund të procesit.
- Gjashtë raporte rajonale përmbledhëse në Ballkanin Perëndimor, një për çdo fushë të RAP (6 në total)


I.2 Pse dhe si WeBER monitoron fushën e “Strategjisë së RAP”

Fokusi i WeBER mbi zhvillimin e politikave dhe koordinimin e RAP është i rëndësishëm për disa arsye. Një kuadër strategjik i mirëzhvilluar për RAP-in — një kornizë e qartë e dokumenteve planifikuese të RAP-it që përcakton objektivat, masat, aktivitetet dhe burimet financiare — siguron një udhërrëfyes të qartë për reformimin e mënyrës se si institucionet publike ndërveprojnë me qytetarët. Monitorimi i jashtëm i angazhimeve të qeverisë për procese transparente dhe gjithëpërfshirëse në këtë fushë është shumë i rëndësishëm për të mbajtur procesin e reformës në rrugën e duhur dhe për të siguruar një progres të dobishëm. Pikërisht këtu del në pah roli i aktorëve jo-shtetërorë, të cilët ushtrojnë presion të jashtëm mbi qeveritë për të përmbushur angazhimet e tyre dhe për të raportuar rregullisht mbi ecurinë. Për më tepër, përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë si në hartimin ashtu edhe në monitorimin e zbatimit të dokumenteve planifikuese të RAP-it, forcon parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes — shtylla thelbësore të qeverisjes së mirë. Pa këto parime, asnjë politikë, përfshirë atë të RAP si një reformë gjithëpërfshirëse, nuk mund të zbatohet efektivisht në dobi të shoqërisë. Angazhimi i shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë jo-shtetëror në proceset e zhvillimit dhe koordinimit të politikave të RAP nuk është thjesht e dobishme por e domosdoshme për llogaridhënien e qeverisë dhe përmirësimin afatgjatë të administratës publike.

Monitorimi i **Strategjisë për RAP** bazohet në një nga Parimet e SIGMAs në këtë fushë:

Parimi 1: Agjenda e reformës në administratën publike gjithëpërfshirëse, e besueshme dhe e qëndrueshme ndërtohet dhe zbatohet me sukses, duke nxitur inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Ky parim vlerësohet plotësisht nga këndvështrimi i cilësisë së përfshirjes së shoqërisë civile dhe publikut në proceset e hartimit të dokumenteve strategjike të RAP-it dhe të pjesëmarrjes në strukturat e monitorimit dhe koordinimit që duhet të garantojnë zbatimin e tyre të qëllimshëm. Fokusi mbi gjithëpërfshirjen dhe transparencën synon të përcaktojë në çfarë mase nevojat dhe pikëpamjet e aktorëve përkatës konsultohen dhe merren në konsideratë gjatë hartimit dhe zbatimit të agjendave të RAP-it.



Periudha e monitorimit për Strategjinë e RAP-it mbulon zhvillimet që nga cikli i fundit i Monitorimit të RAP-it, i cili zgjati nga janari deri në nëntor 2022. Për rrjedhojë, ky raport fokusohet kryesisht në vitet 2023 dhe 2024, si edhe në zhvillimet e fundit të vitit 2022 që nuk janë mbuluar në ciklin e mëparshëm. Megjithëse raporti ofron krahasime të gjetjeve me botimet e mëparshme të Monitorimit të RAP-it, pikët e vlerësimit të shteteve nuk janë të krahasueshme me monitorimin e kaluar për shkak të ndryshimeve të metodologjisë.

Nën-treguesi i parë fokusohet në ekzistencën dhe cilësinë e proceseve të konsultimit gjatë hartimit të dokumenteve planifikuese të RAP-it – strategji zyrtare/plane strategjike, plane/programet e tyre të veprimit, apo çdo lloj dokumenti tjetër planifikues i RAP-it me një periudhë zbatimi së paku dyvjeçare, të miratuara në mënyrë formale nga qeveria ose Parlamenti. Ai vlerëson nëse transparenca dhe gjithëpërfshirja në procesin e hartimit janë të rregulluara ligjërisht, duke vijuar me aspektet praktike të administrimit të konsultimeve – nëse aktorët jo-shtetërorë janë përfshirë që në fazat e hershme, janë ftuar në mënyrë të hapur dhe proaktive, janë pajisur me informacion të plotë dhe u është ofruar përgjigje publike të dokumentuara mbi kontributet e tyre. Gjithashtu, shqyrton nëse publikut i është dhënë mundësia të kontribuojë mbi draft-dokumentet përmes debateve publike dhe, në fund, vlerëson ndikimin

e perceptuar të konsultimeve mbi transparencën dhe gjithëpërfshirjen nga këndvështrimi i të konsultuarve.

Monitorimi i legjislacionit dhe i zbatimit të tij kryhet përmes kombinimit të burimit të dhënave rritur besueshmërinë e rezultatit, e cila përfshin analizën cilësore të dokumenteve strategjik dhe të dhënat zyrtare që janë të disponueshme publikisht apo të marra nga institucionet përgjegjëse të RAP. Për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit, kërkuesit zhvilluan intervista me informatorë kyç, me aktorë jo-shtetëror të cilët morën pjesë në proceset konsultive.

Elementet e treguesve që janë vlerësuar në nëntreguesin e parë janë të renditura në Tabelen 2.

Tabela 2: Elementet e treguesve të nën-treguesi 1

Elementet e treguesit – numri dhe titulli	Fusha
E1.1 Rregulloret parashikojnë procese transparente dhe gjithëpërfshirëse në zhvillimin e dokumenteve të RAP.	Legjislacion
E1.2 Konsultime me aktorë jo-shtetërorë zhvillohen gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit të RAP	Praktika në zbatim
E1.3 Ftesat për pjesëmarrjen në konsultime të aktorëve jo-shtetëror janë të hapura	Praktika në zbatim
E1.4 Institucionet përgjegjëse janë aktiv për të siguruar që aktorët e jashtëm janë të përfshirë në proces.	Praktika në zbatim
E1.5 Institucionet përgjegjëse ofrojnë informacion të plotë në përgatitjen për konsultime.	Praktika në zbatim
E1.6 Institucionet përgjegjëse publikojnë komentet e marra gjatë procesit të konsultimit	Praktika në zbatim
E1.7 Debatet publike organizohen gjatë përgatitjes së dokumenteve planifikues të RAP	Praktika në zbatim
E1.8 Informatorët kyç e konsiderojnë procesin e zhvillimit të dokumenteve të planifikimit të RAP si transparent dhe gjithëpërfshirës	Rezultatet dhe impakti

Vlerësimi është zhvilluar duke marrë parasysh dokumentet e planifikimit të RAP të miratuara gjatë vitit 2023 dhe 2024, së bashku me dokumentet e miratuara në fund të vitit 2022 pas periudhës së monitorimit të fundit të procesit të RAP. Analiza e këtij nëntreguesi për Shqipërinë përfshin:

- Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030
- Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe planit të veprimit 2023-2026.

- Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 dhe Plani i veprimit 2023 – 2025.
- Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe Plani i Veprimit 2022-2026.

Nën-treguesi i dytë monitoron pjesëmarrjen e shoqërisë civile në strukturat e koordinimit dhe monitorimit të RAP-it, si në nivel politik ashtu edhe në nivel administrativ. Ai fokusohet ekskluzivisht tek organet e ngritura për dokumentin strategjik më gjithëpërfshirës të RAP-it (p.sh., strategjitë e RAP-it). Vlerësimi fillimisht shqyrton nëse agjenda strategjike e RAP-it parashikon pjesëmarrjen e shoqërisë civile në këto struktura. Më pas analizon institucionalizimin e kësaj pjesëmarrjeje konkretisht, formatin e përfshirjes së OSHC-ve në organet administrative dhe politike të koordinimit të RAP-it dhe nëse proceset e përzgjedhjes janë të hapura dhe konkurruese. Në aspektin praktik, nën-treguesi vlerëson rregullsinë e mbledhjeve me pjesëmarrje të OSHC-ve dhe transparencën e komunikimit në lidhje me punën e organeve të koordinimit dhe monitorimit të RAP-it. Në fund, ai vlerëson nëse OSHC-të mund të kontribuojnë në mënyrë domethënëse në punën e këtyre organeve, si një tregues i rezultateve të qasjes pjesëmarrëse në koordinimin dhe monitorimin e agjendës së RAP-it.

Vlerësimi bazohet në shqyrtimin e dokumenteve zyrtare dhe adresave të internetit lidhur me organizimin dhe funksionimin e strukturave të koordinimit dhe monitorimit të RAP. Për vlerësimin e rezultateve dhe impaktit, hulumtuesit zhvilluan intervista me informantë kyç, me përfaqësues të shoqërisë civile të cilët janë anëtarë të këtyre organeve ose kanë qenë të ftuar në këto sesione.

Elementet e treguesit vlerësohen në nën treguesin 2 të renditur në tabelën 3.

Tabela 3: Elementet e treguesit në nëntreguesin 2

Elementet e treguesit – numri dhe titulli	Fusha
E2.1 Pjesëmarrja e shoqërisë civile në strukturat e monitorimit dhe koordinimit parashikohet në agjendën e RAP	Strategji dhe politika
E2.2 Struktura e përfshirjes së OSHC-ve në strukturat administrative për koordinimin dhe monitorimin e RAP mundëson pjesëmarrjen e tyre të rregullt dhe aktive.	Struktura institucionale
E2.3 Struktura e përfshirjes së OSHC-ve në strukturat politike për koordinimin dhe monitorimin e RAP mundëson pjesëmarrjen e tyre të rregullt dhe aktive.	Struktura Institucionale
E2.4 Përfshirja e OSHC-ve arrihet bazuar në një proces të hapur dhe konkurrues.	Struktura Institucionale

Elementet e treguesit – numri dhe titulli	Fusha
E2.5 Takimet e strukturave të koordinimit dhe monitorimit të RAP zhvillohen rregullisht me përfshirjen e OSHC-ve	Praktika në zbatim
E2.6 Puna e strukturave të monitorimit dhe koordinimit të RAP komunikohet në mënyrë transparente.	Praktika në zbatim
E2.7 Informantët kyç mendojnë që ata mund të kontribuojnë në mënyrë domethënëse gjatë takimeve të strukturave të monitorimit dhe koordinimit	Rezultati dhe impakti

II. TRANSPARENCA DHE GJITHËPËRFSHIRJA E ZHVILLIMIT DHE MENAXHIMIT TË AGJENDËS SË RAP

Transparenca dhe gjithëpërfshirja në zhvillimin dhe menaxhimin e agjendës së RAP (pikë 0-100)



II.1 Transparenca dhe gjithëpërfshirja në zhvillimin e dokumenteve të planifikimit të RAP

Parimi 1: Agjenda e reformës në administratën publike gjithëpërfshirëse, e besueshme dhe e qëndrueshme ndërtohet dhe zbatohet me sukses, duke nxitur inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm

Nën-treguesi 1: Transparenca dhe gjithëpërfshirja në zhvillimin e dokumenteve të planifikimit të RAP⁵

Elementet e indikatorit	Fusha e elementit	Pikë
E 1.1 Regulations envisage transparency and inclusiveness of PAR planning documents development process	Legislation	3/5
E 1.2 Consultations with non-state actors are conducted during the development of PAR planning documents	Practice in implementation	4.5/9
E 1.3 Invitations to non-state actors to participate in the consultations are open	Practice in implementation	0/8
E 1.4 Responsible institutions are proactive in ensuring that a wide range of external stakeholders become involved in the process	Practice in implementation	1.25/6
E 1.5 Responsible institutions provide complete information in preparation for consultations	Practice in implementation	6.75/9

5 Përmes nën-treguesit të parë, monitorohet nën-parimi i mëposhtëm i SIGMA-s: Të gjithë palët e interesuara përkatëse konsultohen rregullisht dhe përfshihen në planifikimin dhe monitorimin e RAP-it; RAP-i komunikohet në mënyrë efektive dhe promovohen vlerat e një administrate të mirë publike.

Elementet e indikatorit	Fusha e elementit	Pikë
E 1.6 Responsible institutions publish their feedback on the comments received in the consultation process	Practice in implementation	5/9
E 1.7 Public debates are organised during the development of PAR planning documents	Practice in implementation	8/10
E 1.8 Key informants consider that PAR planning documents development process is transparent and inclusive	Outcomes and impact	0/4
Total score for sub-indicator 1		28.5/60

Ashtu si në ciklet paraardhëse të monitorimit të WeBER, kuadri strategjik i reformës së administratës publike (RAP) në Shqipëri përfshin disa dokumente planifikues. Strategjia e mëparshme ndërsektoriale e RAP ishte e vlefshme deri në vitin 2022⁶ dhe vetëm me 3 shkurt 2025 u publikua për strategjia e reformës ndërsektoriale të administratës publike 2024-2025.⁷ Prandaj, ky raport analizon dokumentet zyrtare aktuale të planifikimit që përbëjnë kuadrin strategjik, të cilat përfshijnë: Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030 dhe Planin e Veprimit 2023–2026, Strategjinë Ndërsektoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeveris-jen Vendore 2023–2030 dhe Planin e Veprimit 2023–2025, si dhe Strategjinë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe Planin e Veprimit 2022–2026.⁸ Dokumentet strategjike, së bashku me procedurat ligjore të ndërmarra për t’i miratuar, përbëjnë grupin e dokumenteve të marra në shqyrtim për të analizuar elementët nën këtë nën-tregues. Megjithatë kuadri strategjik i përgjithshëm për RAP-in mbetet në masë të madhe në të njëjtën linjë krahasuar me ciklin e mëparshëm, dokumentet e përditësuar të planifikimit pasqyrojnë afate të rishikuara dhe prioritete të përditësuara të reformës. Të kombinuara me planet e reja të veprimit, ato ofrojnë bazën për të vlerësuar transparencën dhe gjithëpërfshirjen e proceseve të përfshira në hartimin e dokumenteve planifikuese të RAP-it në Shqipëri.

Në legjislacionin shqiptar, konsultimet me palët e interesuara dhe grupet e synuara gjatë procesit të hartimit të projekt akteve janë të parashikuara, megjithatë nuk janë të detyrueshme për çdo procedurë konsultimi. Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë njeh “mbajtësit e

6 Raporti kombëtar i monitorimit të RAP për Shqipërinë 2021-2022, fq.22, National PAR Monitor 2021/2022 - Albania - WeBER 3.0

7 Draft Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030

8 Vendimi nr. 737, date 13 dhjetor 2023, “Për miratimin e udhëzimeve për reformën e administratës publike 2023–2030”

interesave kolektive apo interesave të gjerë të publikut”⁹ si palë në procedurat administrative. Institucionet publike informojnë këto palë rreth objektivave dhe kohëzgjatjes së procedurës, dhe të drejtave për t’iu qasur atyre.¹⁰ Palët kanë të drejtë që të dërgojnë komente apo sugjerime në çdo fazë të procedurës, ndërsa institucionet publike vlerësojnë dhe ofrojnë feedbackun/vlerësimin e tyre me shkrim.¹¹ Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik njeh si subjekte për njoftim dhe konsultim publik projekt aktet, dokumentet strategjik kombëtar dhe vendorë dhe draft dokumentet e politikave.¹² Ligji e njeh qartë organizatat e shoqërisë civile si grupe interesi në procesin e njoftimit dhe konsultimit,¹³ duke njohur pjesëmarrjen e tyre si në fazën fillestare para draftimit të aktit, në propozimin e draft aktit apo gjatë konsultimit publik.¹⁴ Institucionet angazhohen në identifikimin e aktorëve dhe grupeve të interesit dhe përcaktojnë në cilën fazë këto grupe duhet të përfshihen, nëse në fazën fillestare apo pasi të publikohet drafti, dhe hartojnë planin e konsultimeve mbi draft aktin para draftimit të aktit.¹⁵

Metodologjia e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit (RVN) parashikon gjithashtu përfshirjen e palëve të interesuara kur vlerësojnë ndikimin e projekt ligjeve dhe rekomandojnë ndjekjen e të njëjtëve standarde për draft strategjitë dhe dokumentet e politikave.¹⁶ Grupet e interesit njoftohen dhe ftohet të paktën 20 ditë pune para mbledhjes.¹⁷ Megjithatë, debatet publike nuk janë të detyrueshme për çdo konsultim. Ato organizohen bazuar në rëndësinë e draft aktit dhe në nivelin e interesit publik.¹⁸ Institucioni publik përgjegjës për procesin e konsultimit përgatit një raport konsultimi individual që përfshin komentet që pranohen dhe një raport për ato që nuk janë pranuar. Ky raport publikohet në portalin e konsultimit dhe në faqen e internetit të institucionit përkatës dhe ndahet me të gjitha palët që kanë ofruar komente.¹⁹ Edhe pse nuk ka një afat ligjor për publikimin e raportit, rekomandohet që ai të bëhet publik para miratimit të projekt aktit.²⁰ Përveç kësaj, çdo institucion publikon në portalin e konsultimit publik një raport gjashtëmujor dhe një raport njëvjeçar ku përmbledh të dhënat mbi konsultimin publik. Zyra e Kryeministrit përmbledh

9 Neni 33/2, Ligji 44/2015 Kodi i Procedures Administrative në Republikën e Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/04/30/44>

10 Neni 42/2, Ligji 44/2015 Kodi i Procedures Administrative në Republikën e Shqipërisë.

11 Neni 47-48, Ligji 44/2015 Kodi i Procedures Administrative në Republikën e Shqipërisë.

12 Neni 1/1, Ligji 146/2014 për Njoftimin dhe konsultimin publik , <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146>

13 Neni 2/4 dhe 8/1b, Ligji 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

14 Neni 12; 9/b, 11, Ligji 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

15 Urdhëri nr. 3, datë 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit për procesin e konsultimit publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë faqe. 9, 13, 14.

16 Metodologjia e Vlerësimit të Riskut (2018), Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, faqe. 11, 19, <https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2022/06/RIA-Metodologjia.pdf>

17 Neni 17/2, Ligji 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

18 Neni 17/1, ligji 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

19 Urdhëri nr. 3, date 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit për procesin e konsultimit publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë faqe 26.

20 Urdhëri nr. 3, date 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit për procesin e konsultimit publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë faqe 24.

të gjitha gjetjet e procesit të konsultimit të zhvilluara nga organet e qeverisë qendrore në dy raporte performance, ai gjashtë mujor dhe ai vjetor, të cilët publikohen në të njëjtin portal.²¹ Nga ana tjetër, legjislacioni nuk rregullon transparencën e punës së grupeve të punës për dokumentet planifikuese të RAP-it. Në teori, dispozita të tilla ligjore sigurojnë që organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe palët e tjera të interesuara të mund të marrin pjesë që në fazat e hershme të procesit dhe që rezultatet e konsultimeve të përpilohen dhe të bëhen publike.

Megjithatë, pavarësisht se rregullat i vendosin qartë parametrat për transparencë dhe gjithëpërfshirje²², zbatimi i këtyre masave për dokumente të ndryshme planifikimi nuk është i njëjtë, ku transparenca e konsultimit të grupeve të punës dhe mënyra se si këto gjetje përçohen nuk janë të rregulluara siç duhet. Për disa nga dokumentet kryesore planifikuese të RAP-it të shqyrtuara, përfshirë Udhërrëfyesin për RAP 2023–2030, Strategjinë e Mirëadministrimit të Financave Publike (MFP) dhe Strategjinë Ndërsektoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, vlerësimi konstatoi se konsultimet në fazat e hershme janë organizuar përgjithësisht në përputhje me parashikimet ligjore.²³ Në praktikë, konsultimet me aktorët jo shtetëror u filluan shumë më herët se sa botimi formal i draft dokumenteve, për shembull, në prill 2023 për udhërrëfyesin dhe në mars 2022 për strategjinë kombëtare ndërsektoriale.²⁴ Këto konsultime u zhvilluan mes takime fizike dhe atyre online dhe për dokumentet e punës²⁵ u la kohë mjaftueshëm për të përgatitur komentet. Megjithatë, procesi nuk përfshiu thirrje të hapura të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve ose në kanalet e rrjeteve sociale. Përkundrazi, pjesëmarrja u arrit kryesisht përmes ftesave të drejtpërdrejta, kryesisht me anë të postës elektronike, duke kufizuar kështu hapjen e procesit. Në disa raste, u përfshinë një gamë e gjerë aktorësh të ndryshëm.

Për shembull, nën drejtimin e Departamentit të Administratës Publike, takimet për Udhërrëfyesin e RAP 2023-2030 përfshinë ekspertë të pavarur, akademikë, dhe përfaqësues të OSHC-ve.²⁶ Po ashtu, konsultime lidhur me strategjinë e MFP dhe strategjinë ndërsektoriale kombëtare përfshinin pjesëmarrjen nga organizatat ndërkombëtare, donatorët dhe OSHC-të vendore.²⁷ Megjithatë, në rastin e Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe Planit

21 Urdhëri nr. 3, date 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit për procesin e konsultimit publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë faqe 28, 31.

22 Urdhëri nr. 3, date 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit për procesin e konsultimit publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë faqe9, 13, 14,24,26,28,31

23 Përfundimet janë nxjerrë nga vlerësimi i informacionit të marrë përmes përgjigjeve ndaj kërkesave për të drejtë informimi dhe nga raporti përfundimtar i konsultimeve të strategjive të ndryshme, i publikuar në portalin e konsultimeve.

24 Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare, Dokument “Raporti Final”, Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”

25 Dokumentet e konceptit

26 Aktorë kombëtarë jo shtetëror dhe gjithashtu përfaqësues të SIGMA ose RESPA.

27 Si Delegacioni i BE-së në Shqipëri, UN Women, Ambasada Suedeze, Austriake dhe ajo Zvicerane

të Veprimit 2022–2026, u bënë vetëm referenca të përgjithshme për përfshirjen e shoqërisë civile, pa prova të detajuara mbi gamën apo transparencën e procesit të përzgjedhjes. Në përgjithësi, vërehet mungesë gjithëpërfshirjeje dhe pjesëmarrjeje në procesin e hershëm të konsultimeve nga ana e sindikatave, shoqatave të biznesit dhe organizatave që fokusohen në barazinë gjinore ose në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. I vetmi përjashtim ishte konsultimi për Strategjinë e MFP-së, ku UN Women dha komente dhe sugjerime të konsiderueshme, shumica e të cilave u refuzuan.

Sipas përgjigjeve të marra nga kërkesat për informacion, institucionet përgjegjëse për Udhërrëfyesin dhe Strategjinë e MFP ofruan dokumente pune dhe informacion të qartë mbi kohëzgjatjen dhe kanalet për dhënien e kontributeve.²⁸ Në procesin për hartimin e Udhërrëfyesit 2023-2030, agjendat e takimeve dhe dokumentet mbështetës u ndanë përmes emailit, edhe pse mbetet e paqartë nëse të gjithë materialet (si raportet e screening) ishin shpërndarë para takimit.²⁹

Për Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale pavarësisht se partnerët për zhvillim dhe ekspertët morën pjesë në mënyrë aktive,³⁰ nuk ishte e qartë koha për dërgimin e komenteve. Nga ana tjetër, për agjenden digjitale nuk u ofrua asnjë fakt konkret në lidhje me shpërndarjen e informacionit.³¹ Mekanizma të ndryshëm të dhënies së përshtypjeve u shqyrtuan në strategjitë e ndryshme. Për procesin e hartimit të Udhërrëfyesit, raporti i konsultimeve, i siguruar përmes kërkesës për të drejtë informimi, i grupoi komentet sipas tematikave, pa identifikuar dërguesit individualë ose pa dhënë justifikime të detajuara për secilën përgjigje. Nga ana tjetër, për Strategjinë e MFP-së dhe Strategjinë Ndërsektoriale Kombëtare, komentet u publikuan online me tregues më të qartë se cilat komente u pranuan ose u refuzuan, së bashku me shpjegimet përkatëse.³² Gjithashtu, Agjenda Digjitale mbetet pas në këtë drejtim, pa fakte për ofrimin e komenteve të publikuara mbi kontributet e aktorëve.

Debati publik është një komponent i rëndësishëm i procesit të konsultimit dhe strategjitë e ndryshme i janë nënshtruar gjithashtu kësaj procedure. Për Udhërrëfyesin, thirrja zyrtare për të marrë pjesë në debatin publik u publikua si në faqen e internetit të institucionit ashtu edhe në portalin e konsultimit publik, me debatin që zgjati mbi 57 ditë në dy faza.³³ Pavarësisht periudhës së gjatë të konsultimit, raporti final i debatit publik nuk u publikua asnjëherë

28 Departamenti i Administratës Publike për Udhërrëfyesin dhe Ministria e Financave për MFP

29 Konkluzionet e dala nga përgjigjet e marra përmes ligjit për të drejtën e informimit dhe nga intervistat me aktorët kryesorë

30 Si ambasada suedeze dhe ajo zvicerane gjithashtu dhe OSHC si IDM dhe IDRA.

31 As përmes përgjigjeve përmes të drejtës së informimit apo raporteve publike finale në portalin e konsultimeve.

32 Strategjia kombëtare ndërsektoriale, Dokumenti “Raporti Final”, Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”; RENJK_721_RaportKonsultativ.pdf

33 Lista Konsultimeve

online. Për strategjinë e MPF-së, debati publik zgjati 31 ditë³⁴, pak më pak se minimumi statutor³⁵, edhe pse komentet u publikuan, faktet tregojnë që procesi mund të ishte më i strukturuar pasi pjesa më e madhe e komenteve u refuzuan.³⁶ Debati publik për Strategjinë kombëtare ndërsektoriale, i cili zgjati 48 ditë plotësoi pjesën më të madhe të kriterëve³⁷, ndërsa debati publik për Agjendën Digjitale, i zhvilluar vetëm për 15 ditë³⁸, nuk plotësoi kërkesat e afateve të përcaktuara me ligj.

Intervistat me informantët kyç³⁹ ofruan mendime të ndryshme në lidhje me transparencën dhe gjithëpërfshirjen në procesin e zhvillimit të dokumenteve planifikues të RAP. Për Udhërrëfyesin, një i intervistuar u pajtua plotësisht se procesi ishte transparent dhe gjithëpërfshirës, ndërsa një i intervistuar tjetër tregoi se përfshirja varej kryesisht nga kontaktet personale sesa nga një qasje sistematike. Në rastin e Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale, për shembull, një informator kyç ishte shumë i kënaqur me procesin, duke vënë në dukje se kontributet e tyre u diskutuan dhe u integruan. Nga ana tjetër, ky nuk është rasti në çdo proces të zhvillimit të strategjisë. Një ekspert tjetër shprehu shqetësimin se kontributet e tyre si OSHC nuk ishin domethënëse sepse pikat kryesore të këtyre strategjive mbetën kryesisht të pandryshuara nga draftet origjinale të prodhuara nga institucionet përkatëse. Nga këto përgjigje të ndryshme nuk u rrit plotësimi i pragut për marrjen e pikëve për këtë element dhe reflektojnë vështirësitë e vazhdueshme për tu siguruar që proceset e konsultimit janë të qëndrueshme dhe konsiderohen transparente dhe gjithëpërfshirëse nga të gjithë aktorët.

Në tërësi, kuadri rregullator i Shqipërisë ofron një bazë të fortë në garantimin e transparencës dhe përfshirjen në zhvillimin e dokumenteve të planifikimit të RAP. Konsultimet e hershme dhe debatet publike në përgjithësi zhvillohen në kohën e duhur dhe përfshijnë aktorë të ndryshëm jo-shtetërorë. Nga ana tjetër, vihen re disa mangësi në proces si mungesa e thirrjeve të hapura për pjesëmarrje të aktorëve jo-shtetëror, rregullime të kufizuara për organizimin e grupeve të punës, dhe mungesa e publikimeve mbi detajet e komenteve përgjatë konsultimit. Për më tepër, kur ftesat nisen veç nga institucioni përgjegjës⁴⁰ apo në bazë të kontakteve personale kjo gjë e kufizon hapjen e procesit. Këto gjetje sugjerojnë që pavarësisht se kërkesat ligjore plotësohet, ka vend të konsiderueshëm për përmirësim për të siguruar që procesi i zhvillimit të planeve është transparent për aktorët e jashtëm dhe gjithëpërfshirës për aktorët përkatës.

34 PVKM "Per miratimin e Strategjise Sektoriale per Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030"

35 19 ditë pune duke përjashtuar 3 ditë pushim më pak se 20 ditë të parashikuar në legjislacion

36 RENJK_721_RaportKonsultativ.pdf

37 Projektvendim "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve"


38 Projektvendimi "Për miratimin e Agjendës Digjitale 2021+ dhe Planit të Veprimit 2021+

39 Ekspertë kombëtar nga OSHC-të dhe academia.

40 Urdhër nr. 3, datë 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit të Procesit të Konsultimit Publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministria e Republikës së Shqipërisë

Si paraqitet Shqipëria në aspektin rajonal?

Nën-tregues 1: Transparenca dhe gjithëpërfshirja në zhvillimin e dokumentave planifikues të RAP



II.2 Transparenca dhe gjithëpërfshirja e strukturave të monitorimit dhe koordinimit të RAP

Parimi 1: Agjenda e reformës në administratën publike gjithëpërfshirëse, e besueshme dhe e qëndrueshme ndërtohet dhe zbatohet me sukses, duke nxitur inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Nëntregues 2: Transparenca dhe gjithëpërfshirja në strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP⁴¹

Elementet e indikatorit	Fusha e elementit	Pikët
E2.1 Pjesëmarrja e shoqërisë civile në strukturat e monitorimit dhe koordinimit parashikohet në agjendën e RAP	Strategji dhe politika	2/2
E2.2 Struktura e përfshirjes së OSHC-ve në strukturat administrative për koordinimin dhe monitorimin e RAP mundëson pjesëmarrjen e tyre të rregullt dhe aktive.	Struktura institucionale	2/3

41 Përmes nën-treguesit të dytë, monitorohet nën-parimi i mëposhtëm i SIGMA-s: PAR koordinohet në nivele politike dhe administrative; ndahen burime të mjaftueshme dhe reformat e planifikuara zbatohen dhe monitorohen në mënyrë efektive.

Elementet e indikatorit	Fusha e elementit	Pikët
E2.3 Struktura e përfshirjes së OSHC-ve në strukturat politike për koordinimin dhe monitorimin e RAP mundëson pjesëmarrjen e tyre të rregullt dhe aktive.	Struktura Institucionale	2/3
E2.4 Përfshirja e OSHC-ve arrihet bazuar në një proces të hapur dhe konkurrues.	Struktura Institucionale	0/4
E2.5 Takimet e strukturave të koordinimit dhe monitorimit të RAP zhvillohen rregullisht me përfshirjen e OSHC-ve	Praktika në zbatim	0/10
E2.6 Puna e strukturave të monitorimit dhe koordinimit të RAP komunikohet në mënyrë transparente.	Praktika në zbatim	0/10
E2.7 Informantët kyç mendojnë që ata mund të kontribuojnë në mënyrë domethënëse gjatë takimeve të strukturave të monitorimit dhe koordinimit	Rezultati dhe impakti	0/8
E 1.8 Key informants consider that PAR planning documents development process is transparent and inclusive	Outcomes and impact	0/4
Pikët totale për nëntreguesin 2		6/40

Në Shqipëri kuadri aktual rregullator për monitorimin dhe koordinimin e agjendës së Reformës së Administratës Publike (RAP) përfshin disa struktura administrative dhe politike brenda një sistemi planifikimi të integruar (SPI).⁴² Ky kuadër ligjor është duke u zhvilluar vazhdimisht, veçanërisht që nga janari i vitit 2024, ku Ministria e Administratës Publike dhe Anti Korrupsionit ka marrë përgjegjësinë e nivelit politik të RAP-it.⁴³ Siç përshkruhet në Udhërrëfyesin e RAP-it 2023–2030, korniza strategjike për RAP-in përfshin strategji të ndryshme dhe krijimi i mekanizmave politikë dhe administrativë përkatës për këto strategji të ndryshme rregullohet nga Urdhëra të ndryshëm të Kryeministrit..⁴⁴

42 Urdhër i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, Pika 1, faqe 1

43 Në këtë Urdhër të ri nr. 90, Ministria përgjegjëse për GMPI-në e parë është Ministria e Shtetit për Standardet e Shërbimeve, e cila u zëvendësua në janar 2024 nga Ministria e Administratës Publike dhe Anti Korrupsionit.

44 Për shembull, Urdhri i Kryeministrit nr. 76, datë 22.4.2022 për Strategjinë e Decentralizimit ose Urdhri i Kryeministrit nr. 57, datë 24.4.2023 për Udhërrëfyesin 2023-2030

Strukturat aktuale të koordinimit dhe monitorimit për Reformën e Administratës Publike rregullohen brenda kuadrit të Grupit të Menaxhimit të Integritetit të Politikave (GMIP), siç përcaktohet nga Urdhri ende ligjërues i detyrueshëm i Kryeministrit nr. 90, datë 1 gusht 2023, i cili zëvendësoi Urdhrin e vjetër nr. 157, datë 22 tetor 2018.⁴⁵ Të gjitha këto struktura, pjesë e sektorit të prioritetit strategjik për Reformën e Administratës Publike, bien nën GMIP-në e parë mbi "Demokracinë, Sundimin e Ligjit dhe Qeverisjen e Mirë".⁴⁶ Ky Urdhër përcakton një qasje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe krijimin dhe riorganizimin e mekanizmave të integruar sektorialë/ndërsektorialë sipas grupeve të ndryshme të menaxhimit të politikave të integruara, dhe gjithashtu parashikon pjesëmarrjen e shoqërisë civile në strukturat e monitorimit dhe koordinimit.⁴⁷ Gjetjet e vlerësimit tregojnë se, ndërsa organizatat e shoqërisë civile kanë arritur të sigurojnë përfaqësim brenda organeve monitoruese dhe koordinuese, përfshirja e tyre është e kufizuar te ftesa, pasi këto organe i nënshtrohen ndryshimeve dhe ristrukturimit të vazhdueshëm. Këto kërkesa dhe mënyrat se si shoqëria civile përfshihet si në nivel administrativ ashtu edhe në atë politik pasqyrohen më tej në secilën strategji specifike.

Në të njëjtin dokument ligjor, Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) është caktuar si sekretariati përgjegjës për koordinimin në nivel qëndror brenda mekanizmit të integruar të menaxhimit sektorial/ndërsektorial.⁴⁸ Në mënyrë specifike, SASPAC koordinon pjesëmarrjen e partnerëve të zhvillimit, informon Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS)⁴⁹ çdo gjashtë muaj rreth funksionimit të GMIP-ve dhe punon me shoqërinë civile, institucionet e pavarura, akademinë dhe organizatat e biznesit për të identifikuar interesat e tyre në ekipet tematike të caktuara dhe GMIP-të specifike, duke ia përcjellë këtë informacion drejtuesit të grupeve përkatëse të integruara. Për axhendën e RAP-it në nën grupit të parë të integruar, Drejtoria e Programimit të Reformës për Administratën Publike brenda Departamentit të Administratës Publike koordinon aktivitetet në nivel administrativ.⁵⁰

Përfshirja e shoqërisë civile në strukturat administrative të monitorimit dhe koordinimit është e parashikuar, por siç u tha më sipër, kjo ndodh vetëm me ftesë pasi OSHC-të nuk janë anëtarë me të drejta të plota.⁵¹ Për shembull, për zhvillimin e udhërrëfyesit të RAP, aktorët jo shtetëror dhe OSHC-të ishin ftuar në tre takime konsultative të ndryshme⁵² në grupin tematik të parë mbi "Demokracinë, Sundimin e Ligjit dhe Mirëqeverisjen". Në një strategji tjetër të

45 Urdhri i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, Pika 17, f. 5

46 Ibid, Aneks 1, Faqe.1-2

47 Ibid, Pika 6, faqe.2; Aneks 1, Faqe.1-2

48 Ibid, Pika 14, 19, 20, faqe.4-5

49 Ky është një organ qeveritar i ngarkuar me koordinimin, shqyrtimin dhe udhëzimin e zhvillimit dhe zbatimit të planeve strategjike kombëtare për të siguruar që politikat dhe strategjitë afatgjata të jenë në përputhje me objektivat e përgjithshme të vendit.

50 Urdhëri nr.57 i Kryeministrit nr.57, date 24.4.2023, Aneksi 2, faqe 2

51 Urdhër i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, faqe.2, pika 6; aneks 1, faqe.1-2

52 Shihni vlerësimin e nëntreguesit një në këtë raport

bazuar në informacionin e marrë nëpërmjet kërkesës për informacion dhe nga faqja e portalit të konsultimit të strategjisë, Ministria e Punëve të Brendshme, institucioni kryesor për Strategjinë e Decentralizimit, përdori mekanizmat e GMIP-së për konsultime me palët e interesuara përkatëse, duke përfshirë OSHC-të e ftuara.⁵³

Po ashtu, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 90 (datë 1.8.2023), kërkesat e të cilit mbi modalitetet e pjesëmarrjes së OSHC-ve në të dy strukturat monitoruese ndiqen nga secila rregullore e zhvillimit të strategjisë së RAP-it, parashikohet pjesëmarrja e shoqërisë civile në strukturat politike të monitorimit dhe koordinimit, por si gjithmonë kur shihet e nevojshme dhe me ftesë, pasi ata nuk janë anëtarë me të drejta të plota në këto struktura.⁵⁴

Vlerësimi, bazuar në parashikimet ligjore, informacionin online dhe intervistat, tregon se përfshirja e OSHC-ve në strukturat si në nivelin politik ashtu edhe në atë administrativ është ad hoc, kryesisht bazuar në ftesat e dërguara me email ose fizikisht, pa praktikën e thirrjeve të hapura. Edhe pse procedurat e zhvillimit dhe monitorimit të strategjisë së RAP-it kërkojnë mbikëqyrje periodike, takimet janë mbajtur në mënyrë të parregullt gjatë dy viteve të fundit, ndonjëherë me boshllëqe që tejkalojnë intervalin e rekomanduar gjashtëmuor, gjë që dëmton vazhdimësinë, impaktin dhe dinamikën e procesit të mbikëqyrjes.⁵⁵ Përveç kësaj, ekziston një mangësi e konsiderueshme në dokumentimin e proceseve të monitorimit dhe koordinimit të RAP-it. Në faqet e internetit të institucioneve përgjegjëse nuk u gjetën procesverbale mbledhjesh ose të dhëna të tjera që detajojnë datat e këtyre mbledhjeve, përveç një rasti më 14 shtator 2023 për një takim në nivel administrativ mbi Udhërrëfyesin e Strategjisë së RAP-it, siç u vërejt edhe në përgjigjet e DAP-it të marra përmes kërkesës për informim.

Gjithashtu, transparencja e procesit në tërësi cenohet nga mungesa e një seksioni të përditësuar në faqet e internetit të institucioneve përgjegjëse, përfshirë Departamentin e Administratës Publike dhe Zyrën e Kryeministrit, ku duhet të jenë të publike raportet e monitorimit ose dokumente që lidhen me strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP-it, një boshllëk i bërë më i prekshëm nga mungesa e një faqeje zyrtare interneti për Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Në pjesën më të madhe, intervistat me ekspertë tregojnë që pjesëmarrja e OSHC-ve në strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP has të njëjtat probleme që u bënë të qarta përgjatë këtij raporti. Ata ndajnë vazhdimisht të këto problematika të ndryshme si pjesëmarrje rastësore ku ftohet përmes emaileve që përcaktohen më parë nga institucioni përgjegjës. Gjithashtu, mënyra se si rekomandimet përfshihen nuk ndryshon mjaftueshëm përmbajtjen e kryesore të strategjive përfundimtare. Përveç kësaj, koordinimi në kohë reale

53 RENJK_567_RAPORT-FINAL-konsultimi-SNDQV.doc, pika 3

54 Urdhri i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, faqe. 2, pika 6; Aneks 1, f. 1-2


55 Administrata publike në Shqipëri 2024, SIGMA faqe 14, https://www.oecd.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html

përmes Sistemit të Planifikimit të Integruar është jofunksional, duke rezultuar në vonesa në ndarjen e informacionit. Gjithastu ekspertët ranë dakord se disa nga sfidat lindin edhe nga ana e shoqërisë civile, për shkak të burimeve njerëzore dhe ekspertizës së kufizuar.

Në përgjithësi, informatorët kyç shprehën se nevojiten përpjekje më sistematike për të njoftuar dhe përfshirë rregullisht OSHC-të në proces dhe për të përmirësuar zbatimin e rekomandimeve të tyre, edhe pse autoritetet vazhdojnë të punojnë për reforma që synojnë forcimin e bashkëpunimit. Në përfundim, ndërsa kuadri rregullator i Shqipërisë për monitorimin dhe koordinimin e RAP-it është i mirë, ai shfaq problematika të dukshme. Nga njëra anë, mekanizmat e monitorimit të RAP-it janë pozitivë në përfshirjen e shoqërisë civile dhe aktorëve jo-shtetërorë, por nga ana tjetër, parregullsia e takimeve, mungesa e qartësisë në modalitetet organizative dhe mungesa e procedurave të thirrjeve të hapura për pjesëmarrje, e dobësojnë sistemin e mbikëqyrjes.


Si paraqitet Shqipëria në aspektin Rajonal?

Nëntreguesi 2: Transparenca dhe gjithëpërfshirja në strukturat e monitorimit dhe koordinimit të RAP



Krahasimi i pikëve totale në Strategjinë e RAP

Treguesi: Transparenca dhe gjithëpërfshirja në zhvillimin e menaxhimit e agjendës së RAP



Një përmbledhje e raportit rajonal për fushën e strategjisë me rezultatet për të gjitha administratat e Ballkanit Perëndimor është i disponueshëm në: www.par-monitor.org

II.3 Rekomandimet për Strategjinë e RAP

II.3.1 Ndjekja e rekomandimeve për Monitorimin RAP 2021/2022

Rekomadime	Afati (Afat-shkurtër/afat-mesëm/afat-gjatë) ⁵⁶	Statusi	Shpjegim
1. OSHC-të duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në strukturat administrative për koordinimin dhe monitorimin e RAP-it, jo vetëm në strukturat e nivelit politik.	Afatshkurtër	Zbatuar	OSHC-të mund të marrin pjesë me ftesë në strukturat administrative të koordinimit dhe monitorimit të RAP-it. Rregulloret e vlerësuara të cituara në raport përcaktojnë këto procedura.
2. Plani vjetor i punës, agjendat dhe procesverbalet e takimeve të GMIP dhe sekretariatit teknik duhet të publikohen.	Afatmesëm	I pazbatuar	Ky rekomandim nuk është zbatuar dhe mbetet në fuqi edhe për këtë cikël monitorimi.
3. Pjesëmarrja e OSHC-ve nuk duhet të kufizohet vetëm tek anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile; ajo duhet të jetë e hapur për të gjitha OSHC-të e interesuara.	Afatshkurtër	I zbatuar pjesërisht	Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht. Ndërsa pjesëmarrja e OSHC-ve nuk është më e kufizuar vetëm tek anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, ajo ende nuk bazohet në thirrje të hapur për pjesëmarrje por nga ftesa të drejtpërdrejta nga institucionet.

⁵⁶ Rekomandimet që mund të zbatohen brenda një viti klasifikohen si afatshkurtra, ato që kërkojnë një deri në tre vjet përcaktohen si afatmesme dhe ato që kërkojnë më shumë se tre vjet konsiderohen afatgjata.

4. Për të inkurajuar pjesëmarrjen e publikut dhe për të dëshmuar transparencë në procesin	Short term	Partially implemented	This recommendation is partially implemented. Not all lead institutions do regularly publish consultation reports that clearly identify the key topics of discussions, comments and feedback received, and their decisions on the contributions.
e vendimmarrjes, institucionet përgjegjëse duhet të publikojnë raporte konsultimi që identifikojnë qartë temat kryesore të diskutimeve, komentet dhe rekomandimet e marra, dhe vendimet e tyre për kontributet e marra.	Afatmesëm	I zbatuar pjesërisht	Ky rekomandim është i zbatuar pjesërisht Jo të gjitha institucionet kryesore publikojnë rregullisht raporte konsultimesh që identifikojnë qartë temat kryesore të diskutimeve, komentet dhe reagimet e marra, si dhe vendimet e tyre mbi kontributet e ofruara.
5. Për të promovuar pjesëmarrje transparente dhe gjithëpërfshirëse, institucionet përgjegjëse duhet të kryejnë konsultime të hershme dhe të përfshijnë – midis palëve të tjera të interesuara – sindikatat, organizatat që mbrojnë barazinë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe shoqatat e biznesit, që në fazat e hershme të procesit të zhvillimit të politikave.	Afatmesëm	Jo i zbatuar	Ky rekomandim nuk është zbatuar dhe mbetet në fuqi edhe për këtë cikël monitorimi.

II.3.2 Rekomandimet për raportin e monitorimit 2024/2025

- Procedura aktuale me ftesa ad-hoc për përfshirjen e OSHC-ve kufizon larmshmërinë dhe transparencën e angazhimit të palëve të interesuara si në proceset e hartimit ashtu edhe të monitorimit. Rekomandohet që Ministria e Administratës Publike dhe Antikorrupsionit, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, të miratojë procedura formale me thirrje të hapura për integrimin e OSHC-ve si anëtare me të drejta të plota në strukturat mbikëqyrëse, si një masë afatmesme e cila synon nxitjen e një qasje më gjithëpërfshirëse dhe sistematike.
- Shpërndarja në mënyrë të paqëndrueshme e materialeve të punës si axhendat e mbledhjeve, raportet e shqyrtimit dhe afatet kohore, cënon aftësinë e palëve të interesuara për t'u angazhuar në mënyrë efektive. Institucionet përgjegjëse, veçanërisht Departamenti i Administratës Publike, duhet të standardizojnë dhe përmirësojnë ndarjen e këtyre dokumenteve nëpërmjet kanaleve zyrtare, një iniciativë afatmesme për të rritur qartësinë dhe qasjen e informacionit të konsultimit.
- Vonesat dhe detajet e pamjaftueshme në publikimin e ofrimit të komenteve në procesin e konsultimit zvogëlojnë në tërësi transparencën dhe llogaridhënien e procesit. Rekomandohet që agjencitë përkatëse të sigurojnë që raportet të konsultimit, me tregues të qartë të komenteve, vendimeve dhe justifikimeve individuale, të publikohen në internet pa vonesë. Kjo është një masë afatshkurtër që synon të përmirësojë besimin e palëve të interesuara në mekanizmin e marrjes së komenteve.
- Për të promovuar pjesëmarrjen transparente dhe gjithëpërfshirëse, institucionet kryesore duhet të sigurojnë që sindikatat, shoqatat e biznesit dhe organizatat me fokus në barazinë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të përfshihen në fazat e hershme të procesit të zhvillimit të politikave, një përpjekje afatmesme për të promovuar pjesëmarrjen transparente dhe gjithëpërfshirëse. Planifikimi i parregullt i mbledhjeve të monitorimit dhe koordinimit, i përkeqësuar nga mosfunksionimi i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), mbivendosja e paqartë e Urdhrave të Kryeministrit si dhe ndryshimet apo ristrukturimet e vazhdueshme të mekanizmave të monitorimit, cenojnë mbikëqyrjen efektive të zbatimit të RAP-it. Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, duhet të qartësojë këto mekanizma, të bëjë të detyrueshëm një orar të rregullt të mbledhjeve (të paktën dy herë në vit) dhe të investojë në përmirësimin e SPI-së për të mundësuar ndarjen e informacionit në kohë reale, si një angazhim afatmesëm për të përmirësuar koordinimin.
- Mungesa e një platforme të dedikuar online që konsolidon të gjitha dokumentet e planifikimit të RAP-it, procesverbalet e mbledhjeve dhe raportet e monitorimit kufizon ndjeshëm qasjen në informacion kryesor. Rekomandohet që Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, të krijojë dhe të mirëmbajë një platformë të tillë, duke siguruar që të përditësohet rregullisht, si një përpjekje afatmesme kritike për rritjen e transparencës në procesin e RAP-it.

METODOLOGJIA

Për këtë raport u përdorën metodat e mëposhtme të kërkimit për mbledhjen e të dhënave dhe llogaritjen e elementeve:

- Analiza e dokumenteve zyrtarë, të dhënave dhe faqeve zyrtare elektronike
- Kërkesa përmes të drejtës së informimit
- Intervista me aktorë dhe informantë kryesorë.

Monitorimi u mbështet kryesisht në analizën e dokumenteve zyrtare të disponueshme publikisht në faqet e internetit të organeve të administratës dhe në të dhënat dhe informacionin e përfshirë në to. Megjithatë, në rastet kur të dhënat nuk ishin të disponueshme, kërkuesit dërguan kërkesa përmes të drejtës së informimit te institucionet përkatëse me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm për dhënien e pikëve për elementët.

Tabela 4. Kërkesat për informacion të dërguara në Shqipëri

Institucioni	Data e dërgimit të kërkesës	Data e marrjes së përgjigjes
Zyra e Kryeministrit	20.11.2024	Pa përgjigje
Departamenti i Administratës Publike	20.11.2024	10.12.2024
Ministria e Financës	20.11.2024	10.12.2024
Ministria e Punëve të Brendshme	20.11.2024	16.12.2024
Agjensia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	20.11.2024	10.12.2024

Intervistat me informatorë kyç u zhvilluan dhe u përdorën si bazë për ndarjen e pikëve për elementet 1.8 dhe 2.7. Ato gjithashtu shërbyen për të mbledhur të dhëna cilësore, të fokusuara dhe të thelluara mbi fenomenet e monitoruara. Intervistat me palë të tjera të interesuara (si përfaqësues të institucioneve të administratës publike) u përdorën gjithashtu për të plotësuar dhe verifikuar të dhënat dhe gjetjet e mbledhura nga burime të tjera. Përzgjedhja e të intervistuarve u bazua në përzgjedhje të qëllimshme, me kampionim me jo-probabilitet, duke synuar bashkëbisedues me ekspertizë specifike mbi temën.

Intervistat me informatorët kyç përfshinë një grup prej katër pyetjesh, ku

pjesëmarrësit shprehën dakordësinë e tyre në një shkallë me katër nivele: nuk jam fare dakord, prirem mos të bie dakord, prirem të bie dakord dhe jam shumë dakord. Pikët për elementet 1.8 dhe 2.7 u vendosen vetëm nëse të gjithë informatorët kyç shprehën se priren të bien dakord ose ishin plotësisht dakord me deklaratën. Gjithashtu, u përdor një grup pyetjesh të hapura që lejonin diskutime me të intervistuarit dhe pyetje shtesë të menjëhershme, në vend të ndjekjes strikte të një formati të paracaktuar. Të intervistuarve iu garantua anonimiteti i plotë sa i përket informacionit personal dhe përkatësisë institucionale/organizative.

Tabela 5. Intervistat e zhvilluara në Shqipëri

Data	Të intervistuar
05.12.2024	Ekspertë, pjesë e akademisë
05.12.2024	Anëtar i një OSHC-ve, ekspert në Reformën e Administratës Publike
11.12.2024	Anëtar i një OSHC-je, ekspert në Reformën e Administratës Publike

Lista e pyetjeve të intervistës

- Elementi 1.8
 1. Në çfarë mase jeni dakord me deklaratën e mëposhtme: Procesi i zhvillimit të dokumentit të planifikimit të RAP ishte transparent.
 - a. Nuk bie fare dakord
 - b. Prirem të mos bie dakord
 - c. Prirem të bie dakord
 - d. Bie plotësisht dakord
 2. Në çfarë mase jeni dakord me deklaratën e mëposhtme: Procesi i zhvillimit të dokumentit të planifikimit RAP ishte gjithëpërfshirës.
 - a. Nuk bie fare dakord
 - b. Prirem të mos bie dakord
 - c. Prirem të bie dakord
 - d. Bie plotësisht dakord

Pyetje shtesë (që nuk u përdorën për ndarjen e pikëve, por të rëndësishme për sigurimin e informacionit cilësor të nevojshme për vlerësimin):

1. Si janë të përfshira organizatat e shoqërisë civile në fazat fillestare të

zhvillimit të dokumenteve të planifikimit?

2. Sa transparente janë afatet kohore, axhendat dhe rezultatet e konsultimeve gjatë zhvillimit të dokumenteve të planifikimit të RAP?
 3. Si janë të dokumentuara dhe integruar komentet dhe kontributet nga aktorë të ndryshëm?
 4. Si merren vendimet kryesore gjatë zhvillimit të dokumenteve të RAP dhe a janë këto vendime të komunikuara qartë te të gjithë palët e përfshira? (për shembull, vendimet mbi pranimin e ndryshimeve të ardhura nga aktorë jo shtetëror, masa specifike, aktivitete, etj)
 5. A ka ndonjë mundësi për ofrimin e komenteve përgjatë të gjithë procesit?
 6. A ka pasur raste kur kontributi i palëve të interesuara ndikoi ndjeshëm në procesin e zhvillimit të procesit të planifikimit? A mund të jepni një shembull?
 7. Gjatë hartimit të dokumenteve planifikuese për RAP-in, a zbatuan autoritetet përgjegjëse forma të ndryshme konsultimi gjatë procesit (si fokus grupe, sondazhe, intervista, dorëzim të komenteve me shkrim, etj.)? Nëse përgjigjja është po, ju lutem shpjegoni.
- Element 2.7
 1. Në çfarë mase jeni dakord me deklaratën e mëposhtme: **Materialet për përgatitje për takimet e strukturave administrative sigurohen në kohë.**
 - a. Nuk bie fare dakord
 - b. Prirem të mos bie dakord
 - c. Prirem të bie dakord
 - d. Bie plotësisht dakord
 2. Në çfarë mase jeni dakord me deklaratën e mëposhtme: **Materialet për përgatitjen e takimeve të strukturave politike sigurohen në kohë.**
 - a. Nuk bie fare dakord
 - b. Prirem të mos bie dakord
 - c. Prirem të bie dakord
 - d. Bie plotësisht dakord
 3. Në ç'masë jeni dakord me pohimin e mëposhtëm: **Takimet e strukturave administrative lejojnë hapësira për të ofruar kontribut domethënës.**
 - a. Nuk bie fare dakord
 - b. Prirem të mos bie dakord

c. Prirem të bie dakord

d. Bie plotësisht dakord

4. Në ç'masë jeni dakord me pohimin e mëposhtëm: **Takimet e strukturave politike lejojnë hapësira për të ofruar kontribut domethënës.**
 - a. Nuk bie fare dakord
 - b. Prirem të mos bie dakord
 - c. Prirem të bie dakord
 - d. Bie plotësisht dakord

Pyetje shtesë (që nuk u përdoren për ndarjen e pikëve, por të rëndësishme për sigurimin e informacionit cilësor të nevojshme për vlerësimin):

1. A mendoni se organizata juaj ka një zë të rëndësishëm në proceset vendimmarrëse brenda strukturave administrative dhe politike? Ju lutem, shpjegoni. A ka pasur raste kur kontributi i organizatës suaj ka çuar në ndryshime ose ka ndikuar në rezultat? Ju lutem, jepni një shembull.
2. Si i merrni përditësimet apo komentet se si janë përdorur kontributet e organizatës tuaj?
3. Si e vlerësoni komunikimin brenda strukturave dhe nga drejtuesit e strukturave përsa i përket efikasitetit dhe afateve kohore?
4. Si do ta vlerësonit transparencën e proceseve të vendimmarrjes brenda strukturave?
5. A besoni se strukturat e koordinimit dhe monitorimit mund të mbështesin më mirë angazhimin dhe të shfrytëzojnë kontributet e shoqërisë civile? Në ç'mënyrë?
6. Si do ta vlerësoni informacionin e publikuar mbi zbatimin dhe monitorimin e RAP-it, pra si do ta vlerësonit qasjen online të informacionit përkatës?

LISTA E BURIMEVE TË REFERENCAVE NË KËTË RAPORT

Kodi i procedurës së administrative në Republikën e Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/04/30/44>

Vendim nr 737, datë 13 dhjetor 2023

Draft Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030

Ligji 146/2014 mbi njoftimin dhe konsultimin publik, <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146>

Lista Konsultimeve

Raporti kombëtar i monitorimit të RAP për Shqipërinë, National PAR Monitor 2021/2022 - Albania - WeBER 3.0

Urdhëri nr. 3, datë 29.1.2021 për Miratimin e Udhërrëfyesit të Procesit të Konsultimit Publik, Sekretari i Përgjithshëm, Kryeministria e Republikës së Shqipërisë

Urdhëri i Kryeministrit nr 57, datë 24.4.2023

Urdhëri i Kryeministrit nr 76, datë 22.4.2022

Urdhëri i Kryeministrit nr.90, datë 1.8.2023

Projektvendim "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve"

Projektvendimi "Për miratimin e Agjendës Digjitale 2021+ dhe Planit të Veprimit 2021+

Administrata publike në Shqipëri 2024, SIGMA, https://www.oecd.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html

PVKM "Per miratimin e Strategjise Sektoriale per Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030"

RENJK_721_RaportKonsultativ.pdf

Metodologjia e Vlerësimit të Riskut (2018), Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, <https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2022/06/RIA-Metodologjia.pdf>



Funded by
the European Union

With funding from
 Austrian
Development
Agency

Produced within Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0 project. WeBER 3.0 is implemented by Think of Europe Network - TEN and Centre for Public Administration Research – KDZ.

WeBER 3.0 is funded by the European Union and the Austrian Development Agency - ADA. Views and opinions expressed are however those of the authors only and do not necessarily reflect those of the European Union or ADA. Neither the European Union, ADA, TEN nor KDZ can be held responsible for them.

For more information, please visit www.par-monitor.org.